Për të filluar këtë bashkëpunim, ekipi i projektit ka hapur një dialog me kryesitë komunale, ka pranuar dhe lexuar dokumentet e ndërlidhura me komunat dhe ka mbledhur të dhëna dhe pikëpamje. Analizat e këtyre materialeve na bëjnë të kuptojmë se si funksionojnë komunat, dhe cilat janë priorititet kyçë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen kryesitë komunale. Ne mënyre të pashmangshme, kjo analizë ka qenë e kufizuar nga koha, materialeve në dispozicion dhe gatishmëria e komunave për të diskutuar planet dhe buxhetet e tyre. Sidoqoftë, ekziston një platformë solide e cila krijon bazë për angazhim të mëtutjeshëm përmes procesit të Binjakëzimit, i cili është i fokusuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetareve të Kosovës.

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje krijon pikënisjen e bashkëpunimit të komunës dhe projektit për Bashkëpunim Evropian për Komuna më të Fuqishme. Synohet që të identifikohet gjendja ekzistuese në administratat komunale në fushat që projekti është angazhuar të jep përkrahje. Po ashtu jepet edhe një deklarate në lidhje me priorititetet e komunës, për të cilat projekti do të jetë përgjegjës për të ndihmuar. Përfundon duke bërë rekomandime për veprimet e përbashkëta që duhet të ndërmerrin për të realizuar këtë ndihmë, dhe që është e ndërlidhur me synimet e pajtuara dhe rezultatet e pritura.

Konteksti i Politikave





Parimet e përgjithshme të Qeverisjes Lokale në Kosovë janë të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, Neni 123, dhe ato përfshijnë parimet e qeverisjes së mirë, transparencës dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve publike, dhe respektimin e Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale.

Legjislacioni i vetëqeverisjes lokale më tutje thekson karakterin e pavarur ligjor te komunave, autonominë e tyre mbi një fushë të gjerë të kompetencave dhe strukturave të brendshme të organeve komunale. Legjislacioni financiar definon se si të hyrat e Kosovës janë të ndara në mes të nivelit të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale.

Qeveria ka miratuar Strategjinë për Reformën e Administratës Publike, më të cilin dokument vizioni për një administratë efikase dhe administratë publike evropiane është i udhëhequr nga tre zotime përmes se cilave qeveria do t'i shërbej qytetaret dhe bizneset: të qenit efektiv në ofrimin e shërbimeve administrative, të qenit eficent nga pikëpamja e kostos dhe te jetë evropiane në organizim dhe në metoda të punës.

Hapat e realizimit të vizionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, janë ndërmarr duke plotësuar pesë qëllime strategjike, e ato janë:

- Të vazhdohet procesi i reformës së qeverisjes lokale
- Të prezantohet një decentralizim i qëndrueshëm fiskal i ndërlidhur me zhvillimin ekonomik;
- Të ndërtoj menaxhment dhe administratë profesionale të komunave;
- Të ngritët pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarje lokale
- Të zhvillohen standartet Evropiane në shërbimet publike

Ajgenda Evropiane për Kosovën, është komentuar në baza vjetore nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Raporti i vitit 2009 deklaron ‘ka dëshmi të forta që sugjerojnë se Qeveria e Kosovës është duke bërë progres në kërkasat e BE-me ndikim ne administratën lokale publike, por ky progres ka nevojë që të thellohet..’ Qeveria i ka detajuar këto kërkesa nëpërmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në Kosovë (PVPE).





PJESA I : Çka e mundëson komunën në ofrimin e shërbimeve?

Udhëheqësia e Komunës

Kryetari i Kllokotit është Sasha Mirkoviq i cili u zgjodh në raundin e parë e zgjedhjeve të vitit 2009 të mbështetur 100% nga elektorati. Në Kuvendin Komunal janë 15 vende dhe këto janë të përbërë nga SLS (10) dhe LDK-së (5).

Nënkyetarit është z. Zoran Bogdanoviq, (SLS) dhe nënkyetarin për komunitete është Refik Halili (LDK). Kryetari i Kuvendit Komunal është Z. Zharko Dejanoviq i cili u zgjodh gjatë takimit të parë në janar të 2010 dhe zëvendës kryetari është Z. Nasip Sinani (LDK)

Kryetari i komunës takohet çdo javë me Bordin dhe nënkyetarët dhe Kryetarin / Zëvendëskryetarin e Kuvendit. Ai është në Bordin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Komuna ka 2 Komitete të detyrueshme dhe një Komitet për Siguri. Ata takohen rregullisht edhe pse nuk ka kalendar të përcaktuar të takimeve. Në rastin e Këshillit për Komunitete dhe Siguri në Komunë në mungesë të Kryetarit Nënkyetari do të veproj si Kryesues. Posaçërisht është theksuar përfaqësimi në Kuvend interesni i grupit të komunitetit ndërlidhës.

Kryetari ka theksuar se për momentin nuk është duke konsideruar asnjë Komitetet shtesë. Në takimin e Kuvendit në maj ai do të prezantoj raportin e parë të progresit për këtë vit .

Për momentin nuk ka Auditor të Brendshëm dhe asnjë zyrtar përgjegjës për Integrime Evropiane. Këto do të paraqesin kërkesa të reja në çdo strukturë.

Kryetari ka pranuar se Komuna ka nevojë të investoj në aftësitë dhe në përvojë dhe nëse është e nevojshme do të shikoj Komunën e Vitisë për rekrutim të përshtatshëm. Po ashtu ka pranuar se është e nevojshme të shikohen të rinjtë nëse është e nevojshme të plotësohen nevojat ekzistuese dhe të reja të komunës. Ai pranon se komunat e vogla përballen me kufizime të personelit dhe se është i hapur për mënyrat e reja të të menduarit në lidhje me përmirësimin e kapaciteteve të organizatës, ndoshta në partneritet me komunat tjera .Ai është mirënjoës për punën e USAID dhe UNDP në mbështetjen e zhvillimit të punonjësve dhe është referuar zhvillimit të ardhshëm duke përfshirë aftësitë e menaxhimit dhe e-qeverisjes.

Kryetari gjithashtu pranon se mund të jetë e nevojshme transferimi i fondeve në mes të sektorit të stafit për të siguruar një bazë për çdo ri-Strukturim të propozimeve.

Zyrtari i të Drejtave të Njeriut është i vendosur në Drejtorinë e Administratës. Drejtorët nuk kanë të përgatitur plan vjetor të punës. Në vend të kësaj ata përgatisin një raport mënyrës që përmirësimin e kapaciteteve të organizatës, ndoshta në partneritet me komunat tjera. Kryetari është duke konsideruar për të shkuar drejt një qasje të planit vjetor.

Ka pasur mirënjoje për lidhjet ndërkombinare dhe lidhjeve në zhvillimin e Planit Zhvillimor dhe Planit të Qëndrueshëm Komunal. Kryetari foli për rëndësinë e të mësuarit nga të tjerët dhe shkëmbimit të përvjoshës.





Politikat, Strategjia dhe Planifikimi

Komuna ka një plan të gjithëpërfshirshëm të integruar të Strategjisë së Zhvillimit të qëndrueshëm të integruar për 2011-2013(një dokument me 28 faqe) të përgatitur nga MDA dhe i financuar nga UNDP. Prioritet strategjike që përfshihen në këtë plan janë që të ofrohen qytetarëve të Kllokotit Shërbime te mira Komunale të veprohen në Qëndrueshmërinë Mjedisore të Komunës dhe të ngrisë dhe promovoja Investimet në Komunë. .

Personeli komunal

Deri tani janë zhvilluar dy runde të punësimit të punonjësve. Në pesë Drejtori punojnë 47 punonjës. Punonjësve i mungon vendi për punë pasi që ndërtesa ekzistuese është shumë e vogël. Në vitin 2011 pritej të ndërtohej ndërtesa e re komunale e financuar nga ECLO.

Struktura ekzistuese e Komunës duhet të rishqyrtohet me ndihmën ndërkombëtareve. Ky ushtrim planifikohej të përfundoj brenda muajit.

Partneritetet dhe Burimet

Burimet e planikuara financiare të komunës për vitin 2011 janë € 856K. 0,9% e këtij buxheti është krijuar me anë të të ardhurave lokale dhe 99,1% është dhënë nëpërmjet granteve ndërqeveritare siç është përcaktuar me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal. Të dhënat janë në tabelën e mëposhtme:

| Burimi | €000s | Përqindja | Mesatarja Komunale |
|--|-------|-----------|--------------------|
| Granti i Përgjithshëm për Administratë | 460 | 53.7% | 32.4% |
| Granti për Shëndetësi | 313 | 36.6% | 40.7% |
| Granti për Shëndetësinë Primare | 75 | 8.8% | 10.9% |
| Grantet tjera(Pylltaria dhe Mirëqenia Sociale) | 0 | 0.0% | 1.3% |
| Totali i Granteve Ndërqeveritare | 848 | 99.1% | 85.3% |
| Të hyrat Vetanake | 8 | 0.9% | 14.7% |
| Totali | 856 | 100.0% | 100.0% |

Buxheti është analizuar sipas kategorive të shpenzimeve siç vijon:

| Burimi | €000s | Përqindja | Mesatarja Komunale |
|-------------------------------|-------|-----------|--------------------|
| Pagat dhe Mëditjet | 558 | 65.2% | 53.6% |
| Mallrat dhe Shërbimet | 71 | 8.3% | 7.6% |
| Shërbimet Komunale | 11 | 1.3% | 2.3% |
| Subvencionet dhe Transferet | 5 | 0.6% | 1.2% |
| Total i shpenzimeve operative | 645 | 75.4% | 64.7% |
| Shpenzimet kapitale | 211 | 24.6% | 35.3% |
| Shpenzimet Totale | 856 | 100.0% | 100.0% |





211mijë € në dispozicion janë ndarë për investimet kapitale në 2 projekte individuale, një skemë e rrugëve dhe trotuareve (€ 129mijë) dhe ndërtimin e një kopshti fëmijësh (€ 82mijë).

Në vitin 2010,përveç buxhetit lokal komuna përfitoi edhe nga infrastruktura e investimeve qendrore në shumë totale prej €260,000.

Në përgjithësi dhe duke pasur parasysh shërbimin të mëparshëm të tij politik në komunën e Vitisë Kryetari ishte në përgjithësi i kënaqur me lidhjen (MOU) që ekzistonte midis 2 autoritetave. Megjithatë ai iu referua disa problemeve pronësore dhe qirasë të cilën e merr Komuna e Vitisë në lidhje me shfrytëzimin e ndërtesës komunale.

Lidhur me Planin mbi Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës, Kryetari ka përmend propozimin e tij të ‘taksës turistike’ për ata të cilët qëndrojnë në hotele në hapësirën e Komunës.

Ne ende nuk kemi informacion për marrëdhënet midis komunës dhe OJQ-ve dhe donatorëve të tjerë, edhe pse disa raportime lajmesh i referohen bashkëpunimit me Komunën. Por, gjatë takimit tonë me Kryetarin ai ka përmendur se Komuna ka një bashkëpunim të mirë me OJQ-në e vetme aktive lokale ‘Bolja Buducnost’ ‘E ardhmja më mirë’.

Proceset

Komuna ka një marrëveshje me një radio stacion vendor ‘Radio Kllokotit’ për transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit. Radio është përdorur edhe për të dhënë njoftim për takimet. Megjithatë, pjesëmarrja në takimet publike dhe në takimet zyrtare të Komunës ishte e ndryshme dhe përcaktohej kryesisht nga interesi për çështje specifike të komunitetit. Sipas drejtorit të Financave, seanca e fundit mbi buxhetin regjistroi zero pjesëmarrje, pavarësisht nga fakti se ngjarja ishte publikuar përmes radios lokale.

Përveç kësaj kryetari i komunës ka seancën ‘derë e hapur’ për publikun në bazë javore. Asnjë anëtarë tjetër i zgjedhur ose zyrtarë nuk është i pranishëm. Për çështjet që nuk janë zgjidhur drejtpërdrejtë, kryetari i komunës informon drejtorin përkatës për veprimet që duhen ndërmarrë dhe pastaj përcillen nëpërmjet shqyrtimit mujor. Nevojën e një Zyrtari për Informim Publik është konsideruar në rishikimin e strukturës komunale.

Kllokoti u themelua si Komunë në vitin 2009. Si rezultat i kësaj deri tanë ende nuk është nënshtruar auditimit.

PJESA 2: Si ofrohen shërbimet?

Shërbimet Rregulluese

Shërbimet rregulluese janë ato shërbime ku komuna kontrollon veprimet e saja të personave individual apo bizneseve ashtu që të mbroj individët tjerë apo komunën si një tersi.

Për këtë analizë ato përfshijnë: planifikimin urban dhe rural, përdorimin dhe zhvillimin e tokës. Regullacionin e ndërtimit dhe kontrollit të standardeve , mbrojtjes së ambientit lokal, shëndetit publik, lejeve,të dhënat e kandastrit, regjistrimit civil, regjistrimit të votueseve, dhe mbrojtjes së pyjeve.





Shërbimet rregulluese në Kllokot janë të ofruara nëpërmjet Drejtorisë së Administratës (27 persona) Urbanizmit, Kadastrit, dhe Gjeodezisë (4 persona). Komuna nuk ka Drejtori Specifike të inspekcionit andaj dy inspektorët të cilët janë për tregti dhe sanitari janë nën Drejtorin e Buxhetit dhe Financave. Sektori i pylltarisë është nën Drejtoratin e Bujqësisë. (2 persona)

Në vitin 2011 Drejtorati i Urbanizmit ka shqyrtuar 6 kërkesa për ndërtim/ Pasi që komuna nuk ka Plan të zhvillimit Komunal dhe as plan urban rregullues Drejtorati ka rishqyrtuar kërkesat bazuar në disa kritere të caktuara të vendosura nga autoritete komunale të cilat kritere duhen të respektohen nga pronarët.

Kllokoti deri tani i ka marr përsipër përgjegjësit në fushën e menaxhimit dhe mbrojtës së pylltarisë nga Komuna amë Vitia. Sipërfaqja me pyll mbulon 347 ha të Komunës ku mbi 1500 ha janë tokë bujqësore në përdorim.

Në vitin 2010 Drejtoriat i Administratës ka lëshuar 571 dokumente të gjendjes civile.

Shërbimet e Përgjithshme

Shërbimet e përgjithshme janë shërbime të ofruara nga komuna për qytetarët në baza individuale apo shtëpiake, të cilat shërbime janë të përgjithshme dhe në përdorim të vazhdueshëm, p.sh mbledhja e mbeturinave

Për këto analiza ata përfshijnë: zhvillimin ekonomik lokal, shërbimet publike dhe komunale, hapësirat publike dhe parqet, turizmin, aktivitetet të lira dhe kulturore.ë

Shërbimet janë dorëzuar kryesisht përmes seksionit të Shërbimeve Publike i cili është nën Drejtorinë e Administratës. Rastet emergjente janë trajtuar ende nga komuna e Vitisë.

Kompanitë e shërbimeve publike në Kosovë janë të organizuara në bazë të ndarjeve rajonale. Sipas kësaj skeme kompanitë e shërbimeve me bazë në Gjilan janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve në komunën e Kllokotit. Mirëpo, komuna ka trashëguar probleme të menaxhimit të cilat komuna amë (Vitia), i ka pasur me kompanitë rajonale të shërbimeve publike, dhe si rezultat i kësaj, Komuna ende duhej të krijoj bashkëpunim të qëndrueshëm me ofruesit e shërbimeve rajonale. Mbledhja e mbeturinave ofrohet në sajë të një kamioni dhe kontejnerëve të dhuruar në kohën e fundit nga USAID.

Shkalla e papunësisë në Kllokot vlerësohet të jetë 70% e popullsisë. ‘Banja e Kllokotit’ është punëdhënësi më i madh, me gjithatë, numri i profesionistëve të mjekësisë dhe terapapeutëve është i kufizuar. Lidhur me Planin Komunal të zhvillimit të qëndrueshëm kryetari ka përmendur propozimin për një ‘tatim turistik’ me të cilin ngarkohen vizitorët në hotelet të lidhur me Banjë.

Kompanitë e ujit mineral në shishe punësojnë një numër të kufizuar të punëtorëve.





Shërbimet e synuara

Shërbimet e synuara ofrohen nga komuna qytetarëve në baza individuale dhe të cilat përdoren gjatë fazës së caktuar të jetës si edukimi apo në disa raste sipas nevojës së veçantë si shëndetësia primare. Atencion të veçantë në këtë analizë i jepet shënimeve ndaj fëmijëve.

Për këtë analizë ato përfshijnë: edukimin shëndetësinë primare, mirëqenien sociale, strehimore për skamnorët dhe shpërndarja i pagesës për ndihmë sociale.

Në Kllokot shërbimet e synuar janë siguruar përmes Drejtoriatit të Arsimit (2 persona) dhe Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (3 persona).

Raporti vjetor i komunës ofron një pamje të kapaciteteve fizike dhe arritjeve arsimore të sektorit të shkollave. Kapaciteti i infrastrukturës shkolllore është matur tani nga hapësira fizike në dispozicion për nxënës. Për shkollat fillore në 2010 në Kllokot hapësira mesatare për nxënës është në përgjithësi e krahasueshme me komunat tjera. Një masë alternative të kapacitetit fizik të shkollës është dhënë duke marrë numrin e nxënësve për klasë.

Në territorin e Kllokotit janë:

Shkolla fillore, Sveti Sava, në Kllokot që ka 8 klasa dhe 117 nxënës. Stafi i punësuar prej 10.

Shkolla fillore, Marko Rajkovic, në Vërboc ka 9 klasa, dhe një strukturë satelitore në fshatin Mogile 4 klasë. Numri total i nxënës është 229 dhe 11 staf të punësuar.

Shkolla fillore 'Gjon Sereci'; EREC, në Mogilla ka dhjetë klasë. Numri total i nxënës është 253, 15 staf të punësuar.

Shkollën e mesme e teknike dhe Ekonomisë ka 8 klasa. Numri i nxënësve është 147, 14 staf janë të punësuar.

Çështjet e ndërlidhura që ndikojnë në Performancën Komunale

Metoda e komunikimit me qytetarë

Kryetari i Komunës ka seancë javore 'dera e hapur'. Seancat e Kuvendit janë të transmetuara përmes Radio 'Kllokoti'. Ëeb faqja ende ka pak përbajtje dhe nuk ka materiale të komitetit apo raporteve të cilat direkt i ofrohen medieve apo publikut.

Aspekti i barazisë gjinore në shërbimet komunale

Përveç Zyrtarit për të Drejtat e njeriut, edhe Drejtori i Administratës është një femër. Anëtaret femra të stafit përbëjnë 30% të fuqisë punëtore. Numri i stafit femra (17) është në rritje të konsiderueshme nga numri 11 femra në stafin të raportuar në Raportin e MAPL-së në shkurt të 2011 për progresin e bërë për ngritjen dhe zhvillimin e komunave të reja.





Pjesa 3: Zonë për Fokus (Rekomandimet)

Si një komunë e re ka një numër të madh fushmane të administratës që janë në fillim të tyre. Bashkëpunimi Projekti Evropian për komuna më të fuqishme do të donte që të pajtohen me Komunën dhe projektet të tjera të asistencës në katër fusha të përqendrimit, ku mund të bëhet një kontribut pozitiv për qytetarët e Kllokotit.

Në diskutim me komunën janë sugjeruar fushat më poshtë:

Përgatitja e Buxhetit, Menaxhimi dhe Kontrolli

Kjo fushë është identifikuar si prioritet kyç për Komuna së bashku me mbledhjen e të ardhurave. Ndihmë me përgatitjen e buxhetit, menaxhimit dhe kontrollit është e nevojshme. Ndihmë me regjistrimin e pronës, operatorët taksi dhe mbledhjen e taksave do të jetë një ndihmë e madhe.

| Zbrazëtira në Ofrim të Shërbimeve; Proseset Efektive të Menaxhmentit Financiar | | | |
|--|--|---|-------------------|
| Veprimi | Treguesit | Rezultatet | Afati kohor |
| Përgatit një plan i cili përkufizon veprimet e nevojitur për përmirësimin menaxhimin e proceseve financiar duke përfshirë përgatitjen, kontrollimet dhe optimalizimin e fitimit. | Adoptimi i proceseve të menaxhimit financiar dhe aplikimi për vitin e ardhshëm financiar nga Komuna. | Proseset financiare të komunave të miratuara nga komuna të cilat janë të përshtatshme për qëllimin dhe i përbahen plotësisht ligj të MAPL-së për Financa. | Janar 2012 |
| Raportet të quartë dhe inteligjente financiare ofrohen menaxhmentit, deputetëve të zgjedhur dhe qytetarëve. | 10 raporte komitetit politik dhe financiar dhe 4 raporte publike qytetarëve | Besim të lartë tek deputetët e zgjedhur dhe qytetarët për pozitën buxhetore të Komunës | Prej Janarit 2012 |
| Referencat PVPE-së | 50.4 50.5 50.7 149.2 150.3 | | |

Shërbimet e Ujit

Duke i njobur vështirësitet ligjore në Kosovë në lidhje me strukturat institucionale për ndërmarrjet e ujit, disa prej të cilave nuk mund të zgjidhen në nivel të vetëm komunal, ndihma mund të jepet në quartësimin dhe përmirësimin e situatës në Kllokot, veçanërisht nëpërmjet ndryshim të dokumentit kontraktual, përcaktimin e marrëdhënieve në mes të komunës dhe kompanisë rajonale të ujit. Projekti është duke hetuar këtë zonë në emër të të gjitha komunave.

| Zbrazëtira në Ofrimin e Shërbimeve: Mungesa e planit për pajisje me ujë dhe kanalizimit të ujit | | | |
|---|----------------------------|------------|-----|
| Veprimi | Treguesi i Përmirësimit të | Rezultatet | Kur |
| | | | |





| | Shërbimit | | |
|--|---|--|--------------|
| Përgatit planet e ujërave komunale në përputhje me praktikat Evropiane | Miratimi i Planit përmes kuvendit komunal | Shërbimet me ujë në Istok janë të koordinuara me dobi të qytetarëve dhe me mbrojtjen e ambientit | Tetor 2011 |
| Implementimi i planeve të cilat zgjerojnë rrjetin e shtëpive me mundësi të pajisjes me ujë të pastër | 20% ngritje të pajisjes së familjeve me ujë | Përmirësimi i kushtet e jetës së qytetarëve | Shtator 2012 |
| Referencat PVPE / SAPD | Pjesë e politikës së SAPD | | Dhjetor 2012 |

Zhvillimi Ekonomik

Komuna nuk ka një plan të Zhvillimit Ekonomik dhe do të mirënjihte ndihmë në këtë fushë. Projekti mund të lidhej me EURED për të siguruar ndihmën e cila është dhënë në këtë fushë.i

| Zbrazetira në Ofrimin e Shërbimeve: Plani Ekonomik Ekzistues ka skaduar | | | |
|--|---|--|--------------|
| Veprimi | Treguesi i Përmirësimit të Shërbimeve | Rezultati | Kur |
| Të Përpiloj planin Lokal Bazik cili reflekton situatën e tanishme të Komunës | Miratimi i Planit të Reviduar në Kuvendin Komunal | Perspektiva e qartë për qytetarët dhe komunitetin e biznesit në lidhje me strategjinë zhvillimore të komunës | Tetor 2011 |
| Hapë qendrën deleguese të për regjistrim të biznese në Kllokot | Regjistrimi i 5 bizneseve duke shfrytëzuar shërbimin delegues | Përmirësimi i eficiencës dhe stimulimi i ndërmarrësve të rinj | Shtator 2012 |
| EPAP Referencat | 55.7, 55.8 | Stimulimi i Bizneseve të Vegjël dhe të Mesëm | Dhjetor 2012 |

Komuna ka Planin për Zhvillim të Qëndrueshëm 2011-2013 por duhet të gjejë burimet për zbatimin e prioriteteve të shfaqura në këtë plan

| Zbrazetira në Ofrimin e Shërbimeve: Mungesa e kapaciteteve për asistencë për konkurrimin e jashtëm | | | |
|--|----------------------------|------------|-----|
| Veprimi | Treguesi i Përmirësimit të | Rezultatet | Kur |
| | | | |





| | Shërbimeve | | |
|--|---|--|-------------------|
| Ngritje e shkathtësive të stafit të përkushtuar brenda Komunës në të gjitha fazat e Programit dhe Projektit Menaxherial: p.sh. <ul style="list-style-type: none">• Identifikimi i përkrahjes së jashtme• konkurimi i jashtëm/procesi i aplikimit zbatimi• menaxhimi dhe monitorimi | Zyrtarët e Komunës në bashkëpunim me ekspertët European zhvillojnë dhe zbatojnë së paku një (1) aplikacion të plotë | Ngritja e mundësive për konkurim për asistencë financiare për projektet kapitale në kuadër të Planit zhvillimor të Komunës | Fillimi Mars 2012 |
| Zbatimi i suksesshëm për financimin e projektit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2011-2013 | Banorët përfitojnë nga 1 projekt shtesë në infrastrukturën komunale | Përmirësimi i kushteve jetësore në Kllotot | Dhjetor 2012 |

Fushat tjera të diskutuara me zyrtarët komunalë për të cilën është kërkuar ndihma, janë treguar si më poshtë, edhe pse projekti nuk mund drejtpërdrejtë të ndihmojë në zgjidhjen e tyre, shqetësimet mund të drejtohen donatorëve dhe partnerëve të tjerë.

Regjistrimi Civil

Trajnimi i stafit për Regjistrimin civil është i nevojshëm pasi ky funksion përpara është kryer nga stafi i komunës së Vitisë.

Planifikimi Urban

Komuna nuk ka përvojë në Planifikimin Urban dhe ndihma është e nevojshme për shkak se një numër i caktuar i ndërtesave ilegale nuk paguan taksa.

Menaxhimi i Mbeturinave

Ndihma mund të jepet në përgatitjen e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në bashkëpunim me kompaninë regionale dhe Komunën siç edhe parashihet me Ligjin e Mbeturinave 02/L-30, Neni 10.

Rryma Elektrike

Mos-pagesa e energjisë elektrike nga një pjesë e popullsisë ka një efekt të dëmshëm në furnizimin e përgjithshëm dhe Komuna do të përfitonte nga asistenca për të përcaktuar mënyra të trajtimit të këtij problemi.





Burimet Vetanake

Komuna ka probleme në ngritjen e të hyrave vetanake dhe do të mirëpriste ndihmën në krijimin e një sistemi për të ndihmuar me këtë funksion, si dhe duke ndihmuar për të zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi për të informuar qytetarët për përgjegjësinë shoqërore.

Çështjet e Tokës

Ka një numër të çështjeve që lidhen me tokën dhe pronën, duke përfshirë regjistrimin, pronësinë, qiratë për ndërtesa komunale që Komuna do të përfiton nga ndihma. Diskutimet e mëtejshme do të jenë të nevojshme për të konstatuar fusha ku projekti mund të jetë në gjendje të ndihmojë.





Aneksi1 – Të dhënat bazë

| Artikulli | | Burimi |
|---|----------------------|--|
| Popullata | 4736 | Gjendja e 2001; te rifreskohet pas regjistrimit zyrtar |
| Hapësira | 23.8 km ² | Nga Agjencionii Kadastral Kosovar |
| Numri i Lagjeve | | Profilet nga AKK |
| Numri i stafit administrativ | 55 | Buxheti i 2011 |
| Numri i drejtoreve | 6 | Komuna |
| Buxheti Total i Vtitit | €769,198 | Buxheti i 2011 |
| Të hyrat vetanake | €8,390 | Buxheti i 2011 |
| Numri i Ulëseve në Kuvend | 15 | Komisioni Zgjedhor |
| Partia Kryesuese | SLS | Komisioni Zgjedhor |
| Numri i rregulloreve lokale në fuqi | | Komuna |
| Numri i nxënëseve ne shkolla fillore | | MASHT |
| Numri i nxënësve në shkolla të mesme | | MASHT |
| Numri i Shkollave Fillore | | MASHT |
| Numri i Shkollave të Mesme | | MASHT |
| Numri i të punësuarve në Arsim, stafi arsimor | | Buxheti i 2011 |
| Numri i qendrave të Mjekësisë Familjare | | Komuna |
| Numri i ambulancave | | Komuna |
| Numri i të punësuarve në shëndetësi | | Buxheti i 2011 |
| Numri i të punësuarve në | | Buxheti i 2011 |





| | | |
|--|-----|------|
| mirëqenien sociale | | |
| Numri i banoreve që marrin asistence sociale | | MPMS |
| Shifrat e përafërtë të pa-punësisë | 70% | MPMS |





Aneksi 2 - Lista kontrolluese të planeve formale

| Plani | Ekziston | E pranuar | Baza ligjore |
|--|------------------------------|-----------|--------------------|
| Plani i Buxhetit Afat Mesëm | Po | Po | |
| Plani Komunal i Zhvillimit | Jo | | Ligji 2003/14 |
| Plani Urban i Zhvillimit | Jo | | Ligji 2003/14 |
| Plani Rregullues Urban | Jo | | Ligji 2003/14 |
| Plani për Zhvillim Ekonomik | Jo | | |
| Plani për Ndërtimin dhe Rindërtimin e Rrugëve Lokale | Jo | | Ligji 2003/11 |
| Plani për Mirëmbajtje Dimërore | Jo | | Ligji 2003/11 |
| Plani për Transportin Lokal | Jo | | Ligji 2004/1 |
| Plani për Menaxhimin e Mbeturinave | Jo | | Ligji 2005/02-L-30 |
| Plani për Ambient dhe Zhvillim të Qëndrueshëm | Jo | | Ligji 03/L-025 |
| Plani për Mbrojtje nga Zjarri | Jo | | Ligji 02/L-17 |
| Plani për Shërbime Sociale dhe Familjare | Jo | | Ligji 02/L-17 |
| Plani Operacional për Shëndetësinë Primare | Pjesë e planit të drejtorisë | | Ligji 2004/04 |
| Plani Arsimor për Shkollimin e mesëm dhe atë primar | Pjesë e planit të drejtorisë | | Ligji 2002/2 |

